



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 35 datë 13.6.2022

**PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS “KORPUSIT” NË RRUGA
“KOLË MJEDA” NË BASHKINË SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 10.5.2022, pas shqyrtimit të projektvendimit të ardhur nga Kryetari i Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1, nënpika 1.7 shkronja “b”, nenin 54 shkronja “ll”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 3 të ligjit nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, shkresës nr. 1391/1 datë 28.3.2019 të Ministrit të Brendshëm “Plani i masave mbi finalizimin e procesit të emërtimeve të qyteteve, bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve në Republikën e Shqipërisë dhe paisjen me adresë të shtetasve shqiptarë”, relacionit të paraqitur nga administrata e bashkisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të emërtimeve të Rrugës “Korpusit” në Rrugë “Kolë Mjeda”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADIJA

Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 17.6.2022